



DIFFERENT & EQUAL  
TE NDRYSHËM & TE BARABARTE

# 2022

# RAPORT VJETOR

ORGANIZATA "TË NDRYSHËM & TË BARABARTË"

[www.differentandequal.org](http://www.differentandequal.org)

Tiranë, 2022



**Vizioni:** “Ne besojmë në një shoqëri pa trafikim, shfrytëzim apo diskriminim, ku çdo njërit i respektohen të drejtat dhe I jepen mundësi të barabarta“



**Misioni:** D&E është një organizatë jo-fitimprurëse e përkushtuar për të dhënë shërbime cilësore për ri/integrimin e viktimave të trafikimit, të shfrytëzimit dhe të abuzimit, dhe për të përmirësuar kontekstin ligjor, institucional dhe social për të parandaluar dhe luftuar këto shkelje të të drejtave të njeriut.



Different & Equal



Different & Equal



Different & Equal



te\_ndryshem\_dhe\_te\_barabarte

# PËRMBAJTJA

|   |    |
|---|----|
| Profili i Rasteve Viktima / Viktima Të Mundshme Trafikimi.....  | 3  |
| Profili i Rasteve Viktima të dhunës në familje.....   | 4  |
| Programe të D&E të zbatuara gjatë Janar – Dhjetor 2022.....   | 6  |
| Projekti: "Sigurimi i shërbimeve riintegruese gjithëpërfshirëse dhe përmirësimi i kuadrit mbrojtës për viktimat e trafikimit në Shqipëri" .....   | 6  |
| Projekti: “Konsolidimi i Sistemeve për Fuqizimin e Viktimave në Shqipëri @ Shkodër (TVESA@Sh)” .....  | 13 |
| Projekti: Ofrimi i shërbimeve alternative (paradite dhe mbasdite)të përkujdesjes së fëmijëve. Për fëmijët e nënave që janë duke rindërtuar jetën e tyre.....  | 14 |
| Projekti “Hapat e vegjël mund të sjellin një ndryshim të madh” .....  | 17 |
| Projekti:“Ofrimi i programeve të riintegritit ekonomik për të paktën 80 të mbijetuara të DHBGJ në bashkitë e Kukësit, Dibrës, Korçës dhe Beratit” .....   | 18 |
| Projekti:“Ofrimi i shërbimeve riintegruese gjithëpërfshirëse, fuqizimi ekonomik dhe përfshirja sociale për viktimat e dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore dhe fëmijëve të tyre në Shqipëri” ..... | 19 |
| Projekti: Fuqizimi i të mbijetuarve të trafikimit për pjesëmarrje dhe përfaqësim në luftën kundër trafikimit .....  | 22 |
| Projekti “Rritja e aksesit në drejtësi për viktimat e krimit nëpërmjet ofrimit të ndihmës ligjore falas”.   |    |
| Koordinimi dhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë në fushën antitrafikim.....  | 24 |
| Manuale, Udhëzues dhe materiale të tjera - Botime.....  | 27 |



## PËRFITUESIT E PROGRAMIT

Gjatë periudhes Janar – Dhjetor 2022 janë asistuar në total në programin riintegruar të organizatës 202 raste dhe 210 fëmijë të tyre

- **111 raste** të asistuar gjatë kësaj periudhe janë viktimat /viktima të mundshme
- trafikimi dhe **38 fëmijë** të tyre.
- **91 raste** janë viktimat të abuzimit seksual dhe dhunës në familje dhe **172 fëmijë** të tyre



## Kategoritë e përfitueseve të asistuar në program

| Kategori  | Total i rasteve të asistuar në program gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2022 | Rastet mbartura nga Dhjetor 2021 | Rastet e reja në program gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2022 |
|---|---|----------------------------------|---|
| Viktima trafikimi / Viktima të mundshme trafikimi | 111   | 82                               | 29  |
| Fëmijë të rasteve VeT shoqëruar me nënat e tyre   | 38  | 27                               | 11  |
| Viktima të abuzimit seksual dhe dhunës në familje | 91  | 46                               | 45  |
| Fëmijë të rasteve VDH shoqëruar me nënat e tyre   | 172   | 92                               | 80  |
| <b>Totali</b>                                     | <b>412</b>  | <b>247</b>                       | <b>165</b>  |

### Profili i Rasteve Viktima / Viktima Të Mundshme Trafikimi

#### Gjinia

| Gjinia       | Numri i rasteve të mbartura | Numri i rasteve të reja | Total      |
|--------------|-----------------------------|-------------------------|------------|
| Femra        | 53                          | 21                      | 74         |
| Meshkuj      | 29                          | 8                       | 37         |
| <b>TOTAL</b> | <b>82</b>                   | <b>29</b>               | <b>111</b> |

#### Mosha

| Mosha                     | 11-15     | 16-18     | 19-21     | 21 over   | Total      |
|---------------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|
| Nr. i rasteve të mbartura | 16        | 23        | 21        | 22        | 82         |
| Nr. i rasteve të reja     | 9         | 6         | 7         | 7         | 29         |
| <b>Total</b>              | <b>25</b> | <b>29</b> | <b>28</b> | <b>29</b> | <b>111</b> |

**Statusi**

| Statusi              | Beqar/e | Martuar | Divorcuar | E/i ve |
|----------------------|---------|---------|-----------|--------|
| <b>Nr. i rasteve</b> | 23      | 4       | 2         | -      |

**Format e shfrytëzimit**

| Forma e shfrytëzimit                 | Nr. i rasteve të reja |
|--------------------------------------|-----------------------|
| Shfrytëzim seksual                   | 15                    |
| Punë e detyruar                      | 2                     |
| Martesë e detyruar                   | 2                     |
| Aktivitet kriminal ( Vjedhje)        | 3                     |
| Shfrytëzim seksual & punë e detyruar |                       |
| Shfrytëzim seksual & lypje           | 4                     |
| Lypje & aktivitet kriminal           | 3                     |

**Vendi ku kanë qenë trafikuar**

| Vendi ku janë trafikuar | Nr i rasteve të reja |
|-------------------------|----------------------|
| Shqipëri                | 26                   |
| Germany                 | 1                    |
| Kosova                  | 2                    |

**Burimi i referimit për rastet e reja të asistuar gjatë Janar - Dhjetor 2022**

| Burimet e referimeve                     | Nr. i rasteve |
|--|---------------|
| MU D&E Tirana & Shkodra                  | 14            |
| Shërbimi social Shtetëror                | 1             |
| Motrat e Nënë Terezës                    | 1             |
| Home Office                              | 1             |
| PMF Shkoder                              | 1             |
| QKPVT                                    | 4             |
| PMF 4, PMF Kashar, PMF 14, PMF Paskuqan, | 6             |
| Argitra Vizion Diber                     | 1             |
| <b>Totali</b>                            | <b>29</b>     |

## PROFILI I RASTEVE VIKTIMA TË DHUNËS NË FAMILJE DHE ABUZIMIT

### Gjinia

| Gjinia       | Numri i rasteve të mbartura | Numri i rasteve të reja | Total     |
|--------------|-----------------------------|-------------------------|-----------|
| Femra        | 44                          | 44                      | 88        |
| Meshkuj      | 2                           | 1                       | 3         |
| <b>TOTAL</b> | <b>46</b>                   | <b>45</b>               | <b>91</b> |

### Mosha

| Mosha                     | 11-15    | 16-18    | 19-21    | 21 over   | Total     |
|---------------------------|----------|----------|----------|-----------|-----------|
| Nr. i rasteve të mbartura |          | 1        |          | 45        | 46        |
| Nr. i rasteve të reja     | 3        | 2        | 1        | 39        | 45        |
| <b>Total</b>              | <b>3</b> | <b>3</b> | <b>1</b> | <b>84</b> | <b>91</b> |

### Statusi

| Statusi              | Beqar/e   | Martuar  | Divorcuar | E/i ve |
|----------------------|-----------|----------|-----------|--------|
| <b>Nr. i rasteve</b> | <b>10</b> | <b>3</b> | <b>32</b> |        |

### Burimi i referimit për rastet e reja të asistuar gjatë Janar - Dhjetor 2022


| Burimet e referimeve  | Nr. i rasteve |
|---|---------------|
| Streha 'Edlira Haxhiymeri'  | 1             |
| Solvodi   | 1             |
| Kordinatore Dhunes - Bashkia Tirane/Elbasan/ Kamez/ Shkodër / Vlorë                   | 5             |
| Qendra Komunitare nr.4 , nr.1 dhe nr.5 Shkodër  | 3             |
| Qendra per Nisma Ligjore Qytetare   | 2             |
| Njesite Ad. nr.7, Kashar, Njesia 12 , Njesia 4, PMF 11, PMF 1, PMF 9, Bathore , PMF 3 | 11            |
| Hapa të lehtë   | 3             |
| Bashkia Shkodër, Kukës, Korçë , Dibër, Rrogozhinë, Kamëz                              | 9             |
| Mary Ward Loreto  | 2             |
| Referuar nga individë   | 2             |
| Giz   | 1             |
| Forumi i Gruas Elbasan  | 1             |
| QKTVDHF   | 4             |
| <b>Totali</b>   | <b>45</b>     |

**Projekti: "Sigurimi i shërbimeve riintegruese gjithëpërfshirëse dhe përmirësimi i kuadrit mbrojtës për viktimat e trafikimit në Shqipëri"**




**Aktivitetet kryesore të projektit:**

- Asistencë direkte për vajzat, gratë dhe meshkujt viktimat të trafikimit në Shqipëri
- Rritja e aksesit në drejtësi për viktimat e trafikimit
- Kthimi i asistuar i viktimave të trafikimit / viktimave të mundshme të trafikimit
- Rritja e bashkëpunimit me vendet kryesore të destinacionit
- Programi i Riintegrimit për Migrantët e Kthyer në Shqipëri



**D&E ka ofruar asistencë riintegruese për viktimat e trafikimit në tre faza:**



**Një paketë e plotë shërbimesh riintegruese është ofruar për përfituesit e programit të riintegrimit të D&E:**

- ✓ Strehim, siguri dhe plan ri-integrimi;
- ✓ Asistencë e menjëhershme mjekësore;
- ✓ Negocim/ ndërmjetësim me familjen;
- ✓ Vlerësime dhe këshillime psikologjike;
- ✓ Mbështetje dhe asistencë ligjore;
- ✓ Asistencë për rregjistrim/vazhdimësinë e sistemit shkollor;
- ✓ Trajnime profesionale;
- ✓ Aktivitete sociale;
- ✓ Mentorim;
- ✓ Këshillim dhe ndihmë për punësim;
- ✓ Mbështetje financiare për strehim;
- ✓ Informacion mbi shërbimet që ekzistojnë në komunitet si dhe kontaktet e nevojshme/ harta e shërbimeve;
- ✓ Programe pune që krijojnë të ardhura;
- ✓ Asistencë dhe mbështetje për fëmijët e viktimave të trafikimit;
- ✓ Monitorim dhe ndjekja e mëpasshme e përfitueseve të programit.



**Përveç asistencës direkte me përfitueset, D&E ka punuar e mbështetur dhe familjen e viktimës- p.sh fëmijët e përfitueses, asistencë për prindin e një minoreni që të gjejë punë, këshillim familjar, etj.**





## **Shërbimet e ofruara për secilin rast gjatë tre fazave të programit përfshin:**



### **Shërbime shëndetësore**


Gjatë vitit 2022 të gjitha rastet janë mbështetur me shërbimin shëndetësor si më poshtë:

- Vlerësimi mjekësor i rasteve të reja të hyra në program
- Adresimi dhe trajtimi i nevojave mjekësore të të gjitha përfitueseve të programit, dhe fëmijëve të tyre
- Analiza rutinë si gjak komplet, bilanc biokimik, eko abdominale, grafi dhe ekzaminime të tjera me specifike
- Rastet të cilat kanë hasur problemet shëndetsore janë referuar në specialistët përkatës dhe janë trajtuar me medikamente. Problemet shendetesore me të shpeshta që janë hasur tek përfitueset kanë qenë kryesisht dermatologjike, okulare, dentare, gjinekologjike dheinfektive (virale, bakteriale dhe mykotike), etj
- Fëmijë të rasteve të akomoduar në strehëz por dhe në alternativat e tjera akomoduese janë ndjekur te konsultori për vaksina dhe kontrole të tjera
- 23 raste kanë marr shërbim te mjekja psikiater ku kanë marr dhe trajtimin e duhur (PTSD, Borderline, Çrregullim Humori Spektri Depresiv, Çrregullim Ankthi, Tipare të Çrregullimit Borderline
- Në muajin Tetor, muaji kundër kancerit të gjirit, D&E mështetur nga UN Women dhe në bashkëpunim me laboratorët INTERMEDICA janë kryer ekografi të gjirit për 20 përfituese të organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë”.
- D&E ka bashkëpunuar me disa institucione shendetësore siç janë: Albanian University - Dega Stomatologji, nëpërmjet të cilit janë ofruar shërbime dentare falas për përfitueset e programit, Poliklinika Nr.9, ISHP, Instituti i Higjenës, Urgjenca Polivalente e QSUT dhe spitali Psikiatrik.
- Të gjitha përfitueset e programit janë pajisur me Kartë Shëndeti, pranë Pol.nr 9 dhe kanë marrë shërbimin e nevojshëm.



## Këshillimi psiko-social

Këshillimi psikologjik dhe psiko-social, terapia e artit, terapia okupacionale, janë aktivitetet e organizuara në kuadër të asistencës psiko-sociale. Të gjitha këto aktivitete synojnë mirëqenien psikologjike të përfituesve



## Këshillim psikologjik

Një vlerësim psiko-social është bërë për rastet që kanë hyrë në program. **470 seanca këshillimi individuale janë ofruar nga psikologu.** Gjatë kësaj periudhe çështjet e trajtuara në seancat e këshillimit kanë qenë: çështje të lidhura me traumën, ankthin, depresionin, luhatjet e humorit, çrregullime të ndryshme të personalitetit, problemeve të marrëdhënies dhe rutinave të shëndetshme. Gjithashtu janë zhvilluar seanca me qëllim edukimin dhe informimin mbi mëmësinë dhe kujdesit ndaj foshnjave/fëmijëve, menaxhimit emocional si dhe zhvillimit të potencialit personal etj


## Terapi arti

Terapia e artit ka gjithmonë një efekt pozitiv tek përfitueset pasi është një aktivitet çlirues dhe relaksues. Janë organizuar 33 sesione art terapie me pjesëmarrjen e 10 përfitueseve gjatë periudhës raportuese dhe teknikat e përdorura kanë qenë: punë në telajo dhe shprehja e ndjenjave dhe mendimeve përmes pikturës, mesazhe dedikuese për nënat, mësuesit, dashuria si një koncept themelor i ekzistencës, shprehja e revoltës nëpërmjet pankartave dhe emocioneve komplekse që ato mbartin, teknika relaksuese antistres nëpërmjet asosacioneve të lira përmes përdorimit të rërës sintetike, realizimi i sesioneve fotografike për realizimin e një ekspozite nga vet ato.



## Punë kreative dhe terapi okupacionale

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar 15 seanca të terapisë okupacionale me pjesëmarrjen e 10 përfituesve. Disa nga aktivitetet e organizuara ishin: realizimit të vazove, pikturave, cantave të dhuratave, kartolinave, bizhuterive, dekorimit të ambjentit festiv me rastin e festës së Shën Valentinit, 7-8 Marsit, Ditës së Verës dhe ditëlindjeve, realizim pankartave dhe seteve fotografike. Krijimi i maskave për Hallouin, Dekorime festive për Festën e Pavarësisë dhe të Flamurit, Bërja e kartolinave me dekorime të ndryshme, etj.






## Këshillimi psiko - social

**2809 seanca individuale** të këshillimit psiko-social janë ofruar nga menaxherët e rasteve. Çështjet e sjella në këshillim janë kryesisht të lidhura me punësimin, marrëdhëniet ndërpersonale, ndërmjetësimin me familjen, fuqizimin, menaxhimin e kohës dhe të ardhurave, vendimmarrjen dhe zgjedhjet, prindërimin, arsimin, vetë-kujdesin dhe jetesën e pavarur.

## Edukimi dhe shkollim

Një vlerësim për përcaktimin e nivelit arsimor të çdo përfituesi/eje në program realizohet nga mësuesja e D&E dhe në bazë të këtij vlerësimi zhvillohet një plan edukativo - mësimor si pjesë e planit të riintegritimit të çdo përfituesi.

Gjatë kësaj periudhe **60 raste dhe 62 fëmijë** të tyre ndjekin shkollën (**21 VT/VMT and 12 fëmijë të tyre; 39 VDH and 50 fëmijë të tyre**) janë mbështetur dhe kanë ndjekur shkollën në nivele të ndryshme.



Gjatë vitit 2022 të gjitha rastet që vazhdojnë shkollën janë kontaktuar dhe janë ndihmuar vazhdimisht në rast nevojë si; përfitueset në Shelter, në familje dhe fëmijët e përfitueseve. Për rregjistrimin e rasteve në shkollë është bashkëpunuar me Drejtorite Arsimore Rajonale si dhe Ministrinë Arsimi, Sporteve dhe Rinisë. Të gjitha rastet janë pajisur me libra dhe mjete shkollore.



## **Ndihma ligjore**


D&E ka ofruar asistencë ligjore për të gjithë përfituesit/et në program përmes avokatit të D&E. Gjatë periudhës raportuese të gjithë përfituesit e programit të riintegritimit janë informuar për të drejtat e tyre dhe janë mbështetur me ndihmë ligjore sipas nevojave të tyre. Janë kryer vlerësimet ligjore për cdo rast të ri të hyrë në program.

**Në total 40 raste janë mbështetur nga avokate e D&E me ndihmë juridike dytësore për përfaqësim në gjykatë për çështjet penale, civile apo administrative. Kështu nga 40 përfaqësime në gjykatë, 4 kanë qenë procese penale, 33 procese civile dhe 1 proces administrativ.**

Ofrimi i mbështetjes dhe informacion ligjor është dhënë lidhur me: procesin gjyqësor për zgjidhje martesë, autorizim për jashtë shtetit, dokumentacioni për përfitimin e bonusit të qerasë, informim për ligjin "Për të huajt" (pajisjen me leje qëndrimi dhe leje pune), pajisjen me kartë identiteti, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e viktimës në proces penal, të drejtën për të denoncuar në rast të një veprë penale, pagesën si viktimë trafikimi, informacion lidhur me ecurinë e çështjes në prokurori dhe gjykatë, informim për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, informim për ligjin "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", informim për përshpejtimin e procesit në Gjykatën e Apelit, informacion për kujdestarinë e të miturve, informim për ligjin për statusin e jetimit, informim për ligjin e dhunës në familje, informim për pjesëtimin e pasurisë", informacion për ankimimin pranë Kempit Epror.

Rastet janë përfaqësuar në Gjykatën e Shkallës Parë dhe në Gjykatën e Apelit kryesisht për: zgjidhje martesë, pajisja me urdhër mbrojtje, vendosje në përkujdesje alternative, përfaqësim si viktimë e veprës penale për dhunë në familje, abuzim seksual, pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore, lëshim autorizimi për udhëtuar jashtë shtetit me fëmijët e mitur, mosdhënie e mjeteve për jetesë, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, njohjen e vendimit gjyqësor të huaj, pagesën e kujdestarit të të miturit që trajtohet me KMCAP.

**Avokati i D&E ka organizuar sesione me përfituesit duke diskutuar tema të ndryshme ligjore si:**




# Asistenca sociale

## Aktivitetet social - kulturore

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar disa aktivitete sociale për përfitueset. Aktivitetet janë organizuar si brenda dhe jashtë qendrës së riintegritimit.

### Aktivitetet e organizuara brenda strehëzës kanë qenë:



Janë organizuar një sërë aktivitete edhe jashtë strehëzës me karakter zbavitës por dhe informues.

### Disa aktivitete të organizuara jashtë strehëzës janë:



## Asistenca sociale

### Programi i mentorimit

Gjatë kësaj periudhe 5 mentorë kanë ofruar mbështetje individuale në baza javore për disa përfitues/e të programit. 4 prej mentorëve janë përfitues të organizatës të cilët janë në fazë të mirë riintegrimi dhe jetojnë të pavarur dhe mentorojnë përfitues të tjerë të cilët sapo kanë hyrë në programin e organizatës. Mentorët ofrojnë mbështetje në baza javore në përputhje me nevojat e rasteve dhe mënyrat në të cilat janë planifikuar nga të dyja palët. Ky shërbim ofrohet përmes aktiviteteve dhe takimeve periodike. Aktivitetet e organizuara gjatë kësaj periudhe janë përzgjedhur nga rastet sipas interesave dhe dëshirave të tyre, disa prej tyre synojnë edukimin dhe informimin e përfituesit, llojet e tjera të aktiviteteve janë aktivitete relaksuese si sportet, piknik, etj. D&E vazhdimisht ofron supervizim individual dhe në grup për mentorët, kështu procesi i mentorimit është efektiv për përfituesin dhe vetë mentorin.

### Aktivite të organizuara në Klubin e Kauzës Sociale

Janë organizuar aktivitete dhe në Klubin e Kauzës Sociale, e cila është konceptuar për të shërbyer si një vend i përbashkët informal për viktimat e trafikimit, të dhunës në familje dhe fëmijët e tyre, për t'u socializuar, për të organizuar aktivitete dhe për të ofruar shërbime mbështetëse, gjithashtu shërben si qendër burimore - ndarja e informacionit se ku duhet të drejtohen për të marrë ndihmë dhe shërben gjithashtu si pikë për mbledhjen e fondeve. Një zonë e vogël brenda klubit është e përkushtuar për kujdesin dhe argëtimin e fëmijëve të nënave që ndjekin aktivitete si trajnime dhe / ose aktivitete të tjera mbështetëse të bashkëmoshatarëve. Aktivitete të ndryshme organizohen në Klubin Social ku përfituesit kanë marrë pjesë në bazë të dëshirës dhe interesit të tyre.

#### *Disa nga aktivitetet janë:*

- Klubi i parukerisë dhe estetikës;
- Klubi i kujdesit për veten;
- Klubi i kuzhinës;
- Klubi i I punës së dorës;
- Tema të lira, diskutim;
- Klubi i filmit;
- Klubi i Muzikes;
- Klubi i punëve artizanale:  
(përfituesit mbështeten në përgatitjen e punimeve të ndryshme artizanale);
- Klubi i pikturës për fëmijët



Klubi i parukerisë dhe estetikës



Klubi i pikturës për fëmijët



Klubi i kuzhinës



Klubi i Poezisë



Klubi i filmit



Klubi i punëve artizanale



Klubi i Muzikes



## Monitorimi dhe ndjekja e mëpasshme e përfitueseve të programit

Përfitueset e fazës së dytë e të tretë të programit të D&E janë mbështetur me të gjitha shërbimet në komunitet bazuar në nevojat e tyre. Progresi i riintegritimit të rasteve është monitoruar nga menaxherët e rasteve. Monitorimi është realizuar në baza ditore, javore dhe mujore; monitorimi ditor bëhet nga menaxherët e rasteve gjatë turnit të punës. Monitorimi javor dhe mujor realizohet në baza të rregullta nga menaxheri i rasteve të secilit prej rasteve dhe koordinatori i riintegritimit.

Monitorimi i përfituesve është kryer me anë të takimeve direkte, ashtu edhe me anë të kontakteve të rregullta me telefon. **Gjatë kësaj periudhe 2520 sesione monitorimi janë ofruar për përfituesit e fazës së dytë dhe të tretë të programit nga menaxherët e rasteve.** Stafi ka monitoruar dhe ka bërë takime direkte me përfitueset të cilat jetojnë në qytetet e tyre të origjinës si Shkodër, Durrës, Kavajë, Thumanë, Korçë, Fier, Pogradec, Gramsh, etj. **27 raste janë fuqizuar** dhe po jetojnë në mënyrë të pavarur. Në total, **90 raste viktimë /viktimë të mundshme të trafikimit dhe 32 fëmijë të tyre** janë monitoruar nga stafi i D&E.



## Informacion mbi shërbimet në komunitet

Stafi i D&E ofron mbështetje të vazhdueshme për rastet duke u ofruar atyre informacionin e nevojshëm për shërbimet ekzistuese në komunitet. Një hartë të shërbimeve në komunitet u shpërndahet përfituesve, të cilët në disa raste shoqërohen drejtpërdrejt nga menaxherët e tyre të rastit për të njohur drejtpërdrejt këto lloj shërbimesh. Përfituesit informohen për të drejtën e tyre për të përfituar ndihmë ekonomike si VoT dhe ata mbështeten në përpilimin e dokumenteve të nevojshme. Duke qenë se strehimi afatgjat për viktimat e trafikimit është një sfidë, menaxherët e rasteve të D&E kanë vazhduar të ofrojnë mbështetje dhe orientuar përfituesit e fazës së dytë dhe të tretë të programit për përgatitjen e dokumenteve të kërkuara për aplikimin në skemat e strehimit të Bashkisë së Tiranës.



**Rritja e përpjekjeve për fuqizimin ekonomik të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.**

*Trajnime për punësim & Kurse profesionale*

**25**  
përfitues/e

**kanë ndjekur kurse profesionale.**




**Disa përfitues/e kanë ndjekur më shumë se një kurs, bazuar në aftësitë dhe dëshirat individuale.**

| <b>Kurse</b>          | <b>Ofruar</b>  | <b>Nr. i rasteve</b> |
|-----------------------|--|----------------------|
| Kurs Estetike         | Qendra e Formimit Profesional 1  | 3                    |
| Kurs Parukeri         | Qendra e Formimit Profesional 1<br>Qendra e Formimit Profesional 4<br>Afrodite Academy | 1<br>1<br>1          |
| Kurs Kuzhine          | Qendra e Formimit Profesional 1<br>Qendra e Formimit Profesional 4<br>Neranxi<br>ATC   | 2<br>1<br>1<br>1     |
| Kurs manikyr-pedikyr  | Qendra e Formimit Profesional 1  | 3                    |
| Kurs Italisht         | Qendër e Gjuhëve të Huaja private  | 5                    |
| Kurs Gjermanisht      | Qendër e Gjuhëve të Huaja private  | 2                    |
| Kurs Frëngjisht       | Qendër e Gjuhëve të Huaja private  | 1                    |
| Kurs Anglisht         | Qendër e Gjuhëve të Huaja private  | 2                    |
| Kurs Menaxhim Biznesi | Akademia Elita   | 1                    |

## Këshillim për Punësim dhe Punësimi

D&E ka mbështetur përfituesit e programit në përpjekjet e tyre për të hyrë në tregun formal të punës. Stafi i D&E orienton në mënyrë të vazhdueshme përfitueset/it të zgjedhin profesione të kërkuara në tregun e punës, duke u përshtatur në çdo rast me aftësitë e tyre personale. Përfitueset trajnohen se si të paraqiten para punëdhënësit, si të kenë një komunikim efektiv me punëdhënësin, por edhe mbarëvajtjen në punë, si të përgatisin një CV, një letër motivimi etj.

**Rastet e reja në program janë shoqëruar nga kordinatorja për fuqizimin ekonomik për t'u regjistruar pranë Zyrave të Punës si punëkërkuese të papuna.**



**Projekti: Konsolidimi i Sistemeve për Fuqizimin e viktimave në Shqipëri @ Shkodër  
(TVESA@Sh)**

**Partnerët zbatues: D&E - Të Ndryshëm & Të Barabartë në bashkëpunim me  
Bashkinë Shkodër dhe KMOP - Qendra për Veprim Social dhe Inovacion (Greqi).  
Financuar nga: Bashkimi Evropian në kuadër të programit “Mbështetja e BE-së për  
Përfshirjen Sociale në Shqipëri”**

**Kohëzgjatja: Maj 2022 – Prill 2025**

Projekti synon të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve sociale për të mbijetuarat e trafikimit dhe dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Shkodër, sipas nevojave të tyre si dhe në zhvillimin e politikave që ndikojnë në jetën e tyre.

Gjatë kësaj periudhe Maj-Dhjetor 2022 janë mbështetur në total me të gjitha shërbimet riintegruese:

27 raste (23 vajza/gra dhe 4 djem)

9 fëmijë (8 vajza:1 djalë)

7 familjarë të tyre dhe 38 fëmijë (18 djem : 20 vajza)

- Gjatë periudhës Korrik-Dhjetor 2022 janë realizuar dy vlerësime në Bashkinë Shkodër:

1. Vlerësimi i nevojave dhe analiza e mangësive në lidhje me shërbimet, burimet dhe infrastrukturën

2. Vlerësimi i nevojave për trajnim dhe mbështetje të stafit të Bashkisë

Të dy vlerësimet ndihmuan në identifikimin e nevojave dhe ndërhyrjet që duhen bërë në lidhje me shërbimet, burimet dhe infrastrukturën, si dhe kuptimin e nevojave për trajnime në lidhje me ngritjen e kapaciteteve të stafit të Bashkisë. Raportet e vlerësimit janë ndarë me partnerët dhe do të zhvillohet një plan i detajuar veprimi që do ti shtohet përdorimit efektiv të mbështetjes së projektit. Vlerësimet do të shërbejnë gjithashtu si bazë për matjen e efektivitetit të ndërhyrjes së projektit.

- Në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore u inaugurua në 26 Nëntor 2022 në Bashkinë Shkodër, muralja “Dhunë off – Power on” një imazh i artistit Markel Çapo e shoqëruar me vargjet e poetit Martin Camaj. Në inaugurim mori pjesë ambasadorja e BE-së Christiane Hohmann, Kryetari i Bashkisë Shkodër Z. Bardh Spahia, përfaqësues të pushtetit lokal, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile etj. Kjo murale u përgatit në kuadër të projektit në bashkëpunim edhe me Europe House dhe shoqatën Bash-Art.

- Në kuadër të projektit janë përgatitur dhe printuar materialet e vizibilitetit si: baner, fletëpalosje në shqip dhe anglisht, factsheet në shqip dhe anglisht, si dhe postera.

**Projekti: Ofrimi i shërbimeve alternative (paradite dhe mbasdite) të përkujdesjes së fëmijëve. Për fëmijët e nënave që janë duke rindërtuar jetën e tyre.**

- Fëmijë të nënave ish viktime trafikimi dhe viktime të dhunës në familje
- Nëna të vetme - ish viktime trafikimi dhe viktime të dhunës në familje



“Shtëpia e Gjyshes/ Shtëpia Tjetër” është një shërbim komunitar që ofron përkujdesje ndaj fëmijëve të viktimeve të trafikimit dhe dhunës në familje që të marrin kujdesin e duhur pasdite dhe të rriten në një mjedis të qetë, të sigurtë dhe nën përkujdesje ashtu si fëmijët e tjerë, përtej orarit zyrtar të çerdheve, kopshteve dhe shkollave publike (nga e hëna në të shtunë).

Fëmijëve ju ofrohen këto shërbime gjatë kohës së qëndrimit në alternativën e përkujdesit:

- Përkujdesje dhe mbikqyrje
- Kujdes për Higjenën dhe Shëndetin
- Ushqim dhe ushqyerja
- Mbështetje për shkollën/detyrat e shtëpisë
- Mbështetje emocionale dhe mësimin e sjelljeve pozitive sociale
- Lojëra
- Informimin e nënës dhe konsultimin me të lidhur me kujdesin për fëmijën
- Observimin e sjelljeve të fëmijës dhe raportimin e dyshimeve për neglizhim, abuzim apo ekspozim tek dhuna
- Vlerësim dhe mbështetja psikologjike/mjekësore
- Vlerësimi i nevojave dhe planifikimi i kujdesit
- Transporti
- Shëtitjet
- Referimi i nënave dhe fëmijëve për vlerësimin dhe trajtimin e nevojshëm
- Mbështetje për prindërimin për nënat



Nga ky shërbim përkujdesi kanë përfituar gjatë kësaj periudhe 20 fëmijë dhe 16 nëna të vetme/familje:

**Bashkia Tiranë 11 fëmijë**


**“Shtëpia e Gjyshes”**

- Alternativa e përkujdesit është frekuentuar nga 5 fëmijë, 2 djem: 3 vajza.
- Alternativa e përkujdesit mbasdite për fëmijët në çerdhen dhe kopshtin e integruar “Shkozë e Re”
- Alternativa e përkujdesit është frekuentuar nga 6 fëmijë, 3 djem: 3vajza.

**Bashkia Shkodër**

- Alternativa e Përkujdesit Shkodër është frekuentuar nga 9 fëmijë, 1 djalë: 8 vajza.

Fëmijët që frekuentojnë këtë shërbim kanë shfaqur përmirësim të dukshëm dhe të qëndrueshëm të mirëqenies emocionale dhe psikologjike, në procesin e të nxënimit si dhe në arritjen e rezultateve më të mira në shkollë.



### Shtëpia e Gjyshes”

- Alternativa e përkujdesit është frekuentuar nga 5 fëmijë, 2 djem: 3 vajza.
- Alternativa e përkujdesit mbase për fëmijët në çerdhen dhe kopshtin e integruar “Shkozë e Re”
- Alternativa e përkujdesit është frekuentuar nga 6 fëmijë, 3 djem: 3 vajza.

- Alternativa e Përkujdesit Shkodër është frekuentuar nga 9 fëmijë, 1 djalë: 8 vajza.

Fëmijët që frekuentojnë këtë shërbim kanë shfaqur përmirësim të dukshëm dhe të qëndrueshëm të mirëqënies emocionale dhe psikologjike, në procesin e të nxënimit si dhe në arritjen e rezultateve më të mira në shkollë.

### Rritja e përpjekjeve për identifikimin e viktimave / viktimave të mundshme të trafikimit nëpërmjet Njësive Lëvizëse (NJL)

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, Njësia Lëvizëse e Tiranës dhe Shkodrës ka realizuar një sërë aktivitete të cilat përshijnë:

#### Kontakte direkte në terren



**Njësia Lëvizëse Shkoder dhe Tiranë:** Gjatë periudhës Janar- Dhjetor, MU Shkodër dhe Tiranë ka kontaktuar me 64 institucione dhe individ përfaqësues të institucioneve. Qëllimi i kontakteve me institucionet dhe me individët ka qenë marrja e informacionit për rastet vulnerabel për trafikim dhe prezantimi i aktivitetit të MU-së. Gjithashtu, në këto takime në terren është prezantuar edhe shërbimi që D&E ofron për viktimat e trafikimit. Kontaktet janë zhvilluar me individë që kanë njohje në zonë, me administratorët social dhe infermierët e zonave përkatëse, psikologët e shkollave edhe punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve.

## Raste të identifikuara nga MU



Njësitë Lëvizëse Tiranë dhe Shkodër: Gjatë kësaj periudhe janë identifikuar 14 viktima të mundshme trafikimi dhe 7 femijë të tyre.

## Sesione informimi



Në kuadër të muajit Tetor, muajit Të ndërgjegjësimit kundër trafikimit janë realizuar 17 sesione informimi në shkolla ku janë informuar mbi 655 nxënës.

- 1.Gjimnazi Abdulla Keta në zonën e Shkozës . Nr i pjesëmarrësve 40 nxënës.
- 2.Shkolla 9-vjecare Kosova në Njësine Administrative nr 2. Pjesëmarrja 40 nxënës.
- 3.Gjimnazi Alush Bardhi Farkë. Pjesëmarrja 40 nxënës.
- 4.Gjimnazi Arben Broci Njësia 7. Pjesëmarrja 40 nxënës.
- 5.Shkolla 9-vjecare Hillary Clinton Kamez Pjesëmarrja 40 nxënës.
- 6.Shkolla e mesme profesionale Kamez. Pjesëmarrja 50 nxënës.
- 7.SHkolla 9- vjecare Dora D'istria Njësia Ad nr 10 Pjesëmarrja 30 nxënës.
- 8.Gjimnazi Aleks Buda Njësia Ad 11. Pjesëmarrja 50 nxënës.
- 9.Shkolla 9-vjecare Hasan Vogli Njësia 9. Pjesëmarrja 30 nxënës.
- 10.Shkolla 9-vjecare Ferraj ne Dajt .Pjesëmarrja 20 nxënës.
- 11.Shkolla 9 vjecare Kongresi i Manastirit ne Yzberisht Njësia 6.Pjesëmarrja 50 nxënës.
- 12.Shkolla 9-vjecare Shkolla e Kuqe,Njësia nr 8. Pjesëmarrja 35 nxënës.
- 13.Shkolla Konstandin Kristoforidhi Njësia 10. Pjesëmarrja 40 nxënës.
- 14.Shkolla 9-vjecare Drita Pelling Njësia nr 7. Pjesëmarrja 35 nxënës.
- 15.Shkolla 9-vjecare Gustav Mayer Njësia Ad nr 7.Pjesëmarrja 30 nxënës.
- 16-Shkolla 9-vjecare Vasil Shanto Njësia Ad nr 5.Pjesëmarrja 35 nxënës.
- 17.Shkolla 9-vjecare Hasan Tahsin Njësia Ad nr 2.Pjesëmarrja 50 nxënës.

## Fokus grupe të realizuara në komunitet



- 1-Akivitete ndërgjegjësues me përfituesit e Qëndres Sociale "Të Qëndrojmë së Bashku" në Njësinë nr 6. Pjesëmarrja 25 femijë të moshës 12-17 vjec.
- 2-Aktivitet Ndërgjegjësues me banor të komunitetit Rom në Qendrën "T'reja" në njësinë Nr 5. Pjesëmarrja 20 banorë.

## **Bashkëpunime me institucione, partnerë dhe Fokus Grupe të realizuara**

**Njësitë Lëvizëse** kanë realizuar fokus grupe me ndërlidhësat e komunitetit **në Kavajë**, Ndërlidhesa të komunitetit nga Lagjia 4, 5, Synej, Bago, Golem, Memzotaj, Cikallesh, Seferaj, Luzi vogël, Mamël, Helnes, në Vorë me pjesëmarrjen e PMF Vore, Ndërlidhesa të komunitetit në zonat e Vorë Qendër, Marqinet, Prezë, Gërdec, Picar, Kashar me pjesëmarrjen e PMF Kashar, Ndërlidhesave të komunitetit në zonat: Yrshekë, Kus, Mazrek, Kashar zona 1 dhe 2, Katund i Ri, Dajt. Çështjet e trajtuara lidhen me diskutimin mbi familje vulnerabel në Zonat përkatëse, identifikim të personave VMT ose në nevojë për mbrojtje. Ka pasur një bashkëpunim me Punonjëset për mbrojtjen e Fëmijëve dhe Psikologët e shkollave për realizimin e sesioneve. Gjithashtu janë realizuar disa takime ndërsektoriale me disa nga njësitë administrative vendore për forcimin e rrjetit mbështetës, si për menaxhimin e rasteve por edhe për punën parandaluese që duhet bërë në lidhje me viktimat e trafikimit.

Këtu mund të përmendim Bashkinë e Kamzës, Njësine Administrative nr.11, Njësine Administrative nr.12, Njësine Administrative nr.7 dhe Njësine Administrative nr. 6.

## **Projekti “ Hapat e vegjël mund të sjellin një ndryshim të madh”**

**Bashkëpunim mes “Të Ndryshëm & Të Barabartë” në Shqipëri dhe Universitetit Bedfordshire në Mbretërinë e Bashkuar.**

**Periudha: 1 korrik 2020 - 31 Shtator 2022**



“Hapat e vegjël mund të sjellin një ndryshim të madh” është një projekt hulumtimi veprues me pjesëmarrje të të rinjve me qëllim hulumtimin e perspektivave të të rinjve në Shqipëri lidhur me të kërkuarit e ndihmës dhe drejtësisë pas përjetimit të dhunës seksuale.

Projekti “Hapat e vegjël mund të sjellin një ndryshim të madh” synon të identifikojë përvojat e fëmijëve dhe të rinjve që kanë përjetuar dhunë seksuale në sistemin e drejtësisë penale dhe në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve/viktimave në Shqipëri.

## Gjatë kësaj periudhe janë bërë disa aktivitete:

- Është vijuar me takimet me grupin e të rinjëve hulumtues për të përgatitur Raportin e Studimit, përzgjedhja e informacioneve, mesazhet kyce etj
- Gjithashtu janë zhvilluar takime për të vendosur për materialet që do të prodhohen për gjetjet e raportit, audienca që synohet si dhe aktivitetet që do të bëhen në kuadër të këtij projekti.
- Në Tetor 2022 janë organizuar 2 aktivitete për prezantimin e gjetjeve të projektit „ Hapat e Vegjël mund të sjellin një ndryshim të madh“ . Aktiviteti i parë u organizua në datë 27 Tetor 2022 në Qendrën Multidisiplinare „ Ten“ me përfaqësues nga institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile, ndërsa aktiviteti i dytë u organizua në datë 31 Tetor 2022 në ambientet e qendrës „ Atelie“, Bashkia Shkodër.
- Gjatë muajit Nëntor 2022 kanë vijuar takimet për prodhimin e disa materjaleve që kanë si audiencë të rinjtë por edhe institucionet e zbatimit të ligjit. Është përgatitur një video – skenari i të cilës ka ardh nga vet hulumtueset. gjithashtu dhe materiale të tjera si: poster për të rinjtë, postcard etj.
- Në 23 Dhjetor 2022, u organizua workshop – i final i projektit.
- Në kuadër të projektit u përgatit një raport studimor me titull **“Gjetjet tona flasin vetë...”**

**Projekti:“Ofrimi i programeve të riintegritit ekonomik për të paktën 80 të mbijetuara të DHBGJ në bashkitë e Kukësit, Dibrës, Korçës dhe Beratit”**

**Periudha: Qershor 2021 – Shkurt 2023**



Qëllimi i projektit është rritja e kapaciteteve të autoriteteve lokale në Bashkitë, Kukës, Dibër, Korçë, Berat, si dhe OSHC-të e tjera për adoptimin dhe zbatimin e modeleve efektive për integrimin socio-ekonomik të të mbijetuarve të DHBGJ, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes për të mbijetuarit e DHBGJ. D&E po bashkëpunon me tre organizata partnere, shoqatën Tjeter Vision në Elbasan, qendrën psiko-sociale “Vatra” në Vlorë dhe shoqata “Argitra Vizion” në Dibër

